



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 02
Prishtinë, më 22 shkurt 2011, në orën 15:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare

P R O C E S \ V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 22 SHKURT 2011**

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 81 deputetë dhe i deklaroi të hapur punimet e mbledhjes së jashtëzakonshme, të caktuara nga Kryesia e Kuvendit, me kërkesë të grupit prej 50 deputetëve.

Ai përshëndeti përfaqësuesit ndërkombëtarë në Kosovë, si: Piter Feith, Erhard Buhler, Kristofer Dell, përfaqësues të zyrave diplomatike, si dhe përfaqësuesit e bashkësive fetare në Kosovë.

Në vazhdim, ai i njoftoi deputetët se me vendim të presidentit në detyrë, është bërë zëvendësimi i deputetit Ramush Haradinaj me deputetin Bali Muharremaj, nga subjekti politik i AAK-së. Deputetit të certifikuar i dëshiroi punë të mbarë dhe e ftoi ta nënshkruaj deklaratën e betimit.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe
2. Zgjedhja e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

1. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se në pajtim me nenin 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 27 të Rregullores së Kuvendit, kandidat për President të Republikës së Kosovës është nominuar, z. Behgjet Pacolli, aktualisht deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ai kërkoi nga propozuesi që para deputetëve të Kuvendit të paraqet arsyetimin për kandidatin e nominuar për president.

Ibrahim Makolli, deputet i Aleancës Kosova e Re, në emër të grupit të deputetëve paraqiti arsyetimin për kandidatin e nominuar për president.

Në vazhdim, kryetari kërkoi nga Kuvendi formimin e Komisionit për verifikimin e kushteve të kandidatit të nominuar për president, të parapara me Kushtetutë dhe me Ligjin për Presidentin e Republikës së Kosovës, dhe kërkoi që Kuvendi të autorizojë Komisionin e përkohshëm për verifikimin mandateve, i formuar nga Kuvendi në mbledhjen konstituive.

Deputetët miratuan pa asnjë votë kundër propozimin që Kuvendi të autorizojë Komisionin e përkohshëm për verifikimin mandateve, në këtë përbërje:

1. Idriz Vehapi, GP PDK, kryesues,
2. Armend Zemaj GP LDK, anëtar, (mungoi)
3. Alma Lama, GP “Vetëvendosje”, anëtare, (mungoi)
4. Teuta Haxhiu, GP AAK, anëtare, (mungoi)
5. Myzejene Selmani, GP Aleanca për Kosovë të Re, anëtare,
6. Jelena Bontiq, GP SLS, anëtare dhe
7. Albert Kinolli, GP “6+”, anëtar.

Idriz Vehapi, në emër të këtij komisioni, para Kuvendit paraqiti Raportin dhe konstatoi se kandidati për president, Behgjet Pacolli, i plotëson të gjitha kushtet e parapara me Kushtetutë dhe me Ligjin për Presidentin e Republikës së Kosovës.

Kryetari hapi debatin lidhur me propozimin e grupit të deputetëve për kandidatin për President të Republikës së Kosovës.

Opinionet e tyre e dhanë edhe deputetët: Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, Visar Ymeri, në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ardian Gjini, në emër të GP të AAK-së, Slobodan Petroviç, në emër të GP SLS, Mahir Yagcilar, në emër të GP “6+”, si dhe deputetët, Agim Kuleta dhe Liburn Aliu.

Kryetari në vazhdim ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të propozojnë nga një anëtar për Komisionin votues.

Grupet Parlamentare propozuan këta anëtarë:

1. Memli Krasniqi, GP - PDK,
2. Myzejene Selmani, GP - Koalicioni AKR-PD-PSD-PPI-PPK-PNDSH-PGJK,

3. Jelena Bontiq, GP – SLS,

4. Albert Kinolli, GP- “6+”.

Ndërkohë, GP –LDK, GP – “VETËVENDOSJE” dhe GP – AAK nuk ishin në sallë ose e lëshuan atë.

Kuvendi miratoi emërimin e anëtarëve në Komisionin votues.

Në vazhdim, deputetët u ftuan një nga një për të votuar.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues raportin e paraqiti Memli Krasniqi. Ai konstatoi se në votim morën pjesë 67 deputetë dhe rezultati i votimit është si në vijim:

Për-----54,
Kundër----- 11,
Të pavlefshme----- 2.

Kryetari në vijim konstatoi se duhet të shkohet në raundin e dytë të votimit për President të Kosovës, dhe i ftoi deputetët një nga një për të votuar.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues raportin e paraqiti Memli Krasniqi. Ai konstatoi se në votim morën pjesë 67 deputetë dhe rezultati i votimit është si në vijim:

Për-----58,
Kundër----- 7,
Të pavlefshme----- 2.

Kryetari në vijim konstatoi se në fund të këtij cikli votues duhet të shkohet në raundin e tretë të votimit për President të Kosovës, dhe i ftoi deputetët një nga një për të votuar.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues raportin e paraqiti Memli Krasniqi. Ai konstatoi se në votim morën pjesë 67 deputetë dhe rezultati i votimit është si në vijim:

Për-----62,
Kundër----- 4,
Të pavlefshme----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

1. **Behgjet PACOLLI**, zgjedhet President i Republikës së Kosovës.

2. Mandati i presidentit është pesë (5) vjet.

Kryetari ftoi Presidentin e zgjedhur të Republikës së Kosovës, Behgjet Pacollin, të japë betimin: "Betohe se tërë fuqinë time do t'ia kushtoj ruajtjes së pavarësisë, të sovranitetit dhe të integritetit territorial të Republikës së Kosovës, sigurimit të lirive dhe të drejtave njerëzore e qytetare, respektimit dhe mbrojtjes së Kushtetutës dhe të ligjeve, ruajtjes së paqes dhe të mirëqenies të të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe me ndërgjegje e përgjegjësi do t'i kryej të gjitha detyrimet e mia."

Pas dhënies së betimit, Presidenti mbajti një fjalë rasti.

Behgjet Pacolli, në fillim falënderoi deputetët për besimin e dhënë dhe tha se sot është një ditë e madhe sepse fillon edhe sfida e radhës, e cila do të thotë edhe përgjegjësi të reja.

Ai tha se do të angazhohet për vazhdimin e politikës së presidentit të ndjerë, Ibrahim Rugova, dhe për çuarjen në vend të amanetit të të gjithë dëshmorëve, në krye me komandantin legjendar, Adem Jashari.

Në vazhdim, Presidenti falënderoi SHBA-në dhe BE-në për ndihmën e madhe për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Pavarësia e Kosovës është storje e suksesit, ndërsa njohja e shtetit të Kosovës nga 75 vende është e arritur e veçantë dhe virtyt i punës së qytetarëve të Kosovës, tha ai.

Pacolli, më tutje duke e vlerësuar marrjen e besimit për zgjedhjen president vendi, tha se sot ka marrë një detyrim jo të lehtë, dhe siguroi qytetarët se do të përfaqësojë interesat e tyre dhe të Kosovës në mënyrën më të mirë të mundshme, dhe se do të punojë për të mirën e të gjitha shtresave të shoqërisë kosovare, për integritetin territorial të Republikës së Kosovës, etj.

Duke folur për reformat legjislative në vend, presidenti Pacolli tha se do të angazhohet plotësisht që të rregullohet me ligj çështja dhe mënyra e zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Kosovës nga qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Ndërkaq, lidhur me bashkëpunimin në rajon ai vlerësoi lart kontributin e shtetit shqiptar për ndihmën e treguar për Kosovën, vlerësoi gatishmërinë e Republikës së Malit të Zi dhe të Republikës së Maqedonisë për bashkëpunim me Republikën e Kosovës.

Në fund, presidenti shfaqti edhe një herë përkushtimin e tij për ta bërë Republikën e Kosovës një vend të ngritur dhe të respektuar në arenën ndërkombëtare, duke përkujtuar se kjo gjë mund të bëhet me punë, seriozitet dhe profesionalizëm.

2. Zgjedhja e Qeverisë së Republikës së Kosovës

Kryetari njoftoi Kuvendin se ai, në cilësinë e ushtruesit të detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 95 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ia ka propozuar Kuvendit kandidatin për Kryeministër të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi.

I propozuari për kryeministër, z. Hashim Thaçi, ka propozuar përbërjen e Kabinetit të Qeverisë për miratim në Kuvend, tha kryetari.

Ai ftoi kandidatin e nominuar për Kryeministër të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, që para deputetëve të Kuvendit të paraqet përbërjen e Kabinetit qeveritar.

Hashim Thaçi, tha se sot me zgjedhjen e institucioneve të reja po i japim fund një krize institucionale pesëmuajshe. Ai falënderoi qytetarët e vendit për besimin e dhënë por edhe faktorin ndërkombëtarë për interesimin dhe ndihmën e treguar në konsolidimin e demokracisë në vend.

Në vazhdim, tha se për qytetarët e Kosovës muajt e fundit ishin shumë sfidues. Këto shqetësime do të jenë një motiv shtesë për të dhe për tërë kabinetin qeveritar të ardhshëm, që me përkushtim të punojnë për ndërtimin e institucioneve të dala nga zgjedhjet e fundit, dhe se mbi çdo interes tjetër do ta vë interesin e shtetit të Kosovës.

Më tej, tha se mesazhi i tij u adresohet të gjithëve, përfshirë partitë parlamentare dhe shoqërinë civile, ndërsa për këta të fundit tha se do të jenë pjesë e kabinetit të tij.

Si mandatar për formimin e Qeverisë, partnerët e koalicionit: PDK, Aleanca Kosova e Re, SLS, Grupi Parlamentar “6+” dhe Lista “Dr. Ibrahim Rugova”, do të punojmë për reforma të thella demokratike në mënyrë që ky mandat të jetë ai i Kosovës evropiane, do të punojmë për një qeveri kredibile dhe të aftë për integrimet e ardhshme, për zbatimin e planit të Ahtisarit, për krijimin e vendeve të reja të punës, për përsosjen e procesit të privatizimit në Republikën e Kosovës, tha z. Thaçi.

Në vazhdim, i nominuari për Kryeministër të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, para deputetëve të Kuvendit paraqiti disa nga pikat e programit qeverisës 2011 – 2014, të cilat janë dhënë në transkripto, që është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Në fund, i nominuari për kryeministër paraqiti para Kuvendit përbërjen e Kabinetit qeveritar.

Në vazhdim, për fjalë u paraqitën deputetët: Rada Trajković dhe Muhamet Mustafa, fjala e të cilëve është dhënë në transkripto, që është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryetari, më pas kërkoi nga deputetët që me ngritje dore të deklarohen për Kabinetin e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për-----65,
Kundër----- 1,
Abstenim ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Për zgjedhjen e Kryeministrit, të zëvendëskryeministrave dhe të ministrave të Qeverisë së Republikës së Kosovës

I. Zgjedhet Qeveria e Republikës së Kosovës, në këtë përbërje:

1. **Hashim THAÇI**, Kryeministër i Qeverisë së Kosovës,

2. **Hajredin Kuçi**, zëvendëskryeministër i parë dhe ministër i Drejtësisë,
3. **Mimoza Kusari**, zëvendëskryeministre dhe ministre e Tregtisë dhe Industrisë,
4. **Slobodan Petroviq**, zëvendëskryeministër dhe ministër për Qeverisje Lokale,
5. **Edita Tahiri**, zëvendëskryeministre,
6. **Bujar Bukoshi**, zëvendëskryeministër.
7. **Enver Hoxhaj**, ministër i Punëve të Jashtme,
8. **Vlora Çitaku**, ministre për Integritet Evropian,
9. **Agim Çeku**, ministër i Forcës së Sigurisë,
10. **Bajram Rexhepi**, ministër i Punëve të Brendshme,
11. **Bedri Hamza**, ministër i Financave,
12. **Memli Krasniqi**, ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,
13. **Besim Beqaj**, ministër i Zhvillimit Ekonomik,
14. **Ramë Buja**, ministër i Arsimit,
15. **Mahir Yagcilar**, ministër i Administratës Publike,
16. **Fehmi Mujota**, ministër i Infrastrukturës,
17. **Blerand Stavileci**, ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
18. **Ferid Agani**, ministër i Shëndetësisë,
19. **Nenad Rashiq**, ministër i Punës dhe i Mirëqenies Sociale,
20. **Dardan Gashi**, ministër i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe
21. **Tomiq Radoica**, ministër për Kthim dhe Komunitete.

II. Mandati i Qeverisë së Republikës së Kosovës zgjatë katër (4) vjet.

Në emër të Qeverisë së zgjedhur u falënderua z. Hashim Thaçi.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen plenare në orën 19:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Njësia për Çështje Plenare dhe Procedurale